

Prishtinë, Kosovë

25 shtator 2018

**Drejtuar:** Behar Ismës, kryesues i grupit punues për hartimin e Strategjisë për Diasporën (2019-2013) dhe Planit të Veprimit (2019-2021), Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike

**Nga:** OJQ Germin

**Tema:** Ruajtja e Identiteti dhe Fuqizimi i lidhjeve me Diasporën

I nderuar z. Isma,

Më 17 shtator 2018, organizata jo-qeveritare Germin, në kuadër të iniciativës *Angazhimi i Diasporës në Zhvillimin e Politikave, pjesë e Diaspora Flet* ([www.diasporaflet.org](http://www.diasporaflet.org)) ka mbajtur takim virtual me temën "Ruajtja e Identiteti dhe Fuqizimi i lidhjeve me Diasporën", kapitull i Strategjisë për Diasporën 2013-2018.

Paneli diskutues:

1. **Muhamet Idrizi** – mësues i gjuhës gjermane, shkencës politike dhe etikës, Gjermani;
2. **Adriana Veseli** – përfaqësuese e shoqatës shqiptaro-gjermane, Münsterländ e.V., Gjermani;
3. **Petrit Kuçana** – themelues dhe drejtues i platformës "The Albanian" Britani e Madhe;
4. **Naxhije Bujupi** – drejtuese e platformës "TASH" e.V., Gjermani;
5. **Mimoza Leka** – mësuese e mësimit plotësues dhe përfaqësuese e shoqatës kulturore shqiptare RBK e.V., Gjermani;
6. **Avdyl Lipoveci** - Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike, udhëheqës i departamentit për ruajtjen dhe kultivimin e arsimit dhe kulturës në Diasporë.

Diskutimi u moderua nga Fjolla Vukshinaj, Germin.

Organizata jo-qeveritare GERMIN, pjesë e grupit punues për hartimin e Strategjisë për Diasporën (2019-2013) dhe Planit të Veprimit (2019-2021), është duke realizuar një seri diskutimesh virtuale me pjesëtarë të Diasporës për të pranuar rekomandime dhe komente nga komunitetet e Diasporës gjatë hartimit të këtij dokumenti.

Mësimi plotësues jashtë vendit, promovimi i identitetit shtetëror, avancimi i rolit të mediave dhe roli i studentëve nga Diaspora ishin temat e diskutimit të cilat u trajtuan nga paneli diskutues. Gjuha, edhe pse mbetet një ndër faktorët për mbijetesën e komunitetit jashtë Kosovës, vitet e fundit ky proces është përballur me shumë sfida dhe përgjegjësi. Në anën tjetër, duke e konsideruar diasporën, si shtyllë mbështetëse për zhvillim ekonomik për një kohë të gjatë për vendin tonë, ruajtja dhe forcimi i lidhjeve vazhdon të mbetet shumë i rëndësishëm për të dy palët.

Bazuar në situatën e tanishme, mësimi plotësues i gjuhës amtare në Diasporë, ka ende probleme serioze, kryesisht ato kanë të bëjnë me mbulimin financiar të këtij programi dhe kualifikimin adekuat të mësimeve të mësimit plotësues. Përveç mësimit plotësues, u potencua edhe rëndësia e themelimit të një kanali të veçantë për Diasporën në bashkëpunim me Shqipërinë dhe Maqedonin; problemet me nostrifikimin e diplomave; mos-përkrahja e shkencëtarëve dhe hulumtuesve nga Diaspora; nevoja për librat elektronik e të tjera.

Sipas z.Avdyl Lipoveci, disa nga faktorët që penguan realizmin sa më të mirë të aktiviteteve/punës së Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike janë:

1. Buxheti i mangët i minisitrisë;
2. Mos angazhimi i institucioneve tjera;
3. Mos koordinimi i mirë me institucionet e tjera; dhe
4. Numri i madh i Diasporës, shpërndarrja e saj dhe numri i vogël i stafit të ministrisë.

Për këtë, ne po ju dërgojmë rekomandimet e dala nga ky diskutim, të cilat mund të forcojnë një bashkëpunim më të mirë në mes të institucioneve shtetërore dhe pjesëtarëve të diasporës për ruajtjen dhe forcimin e identitetit kombëtar:

- Draft raporti vlerësues për arritjet e Strategjisë së Diasporës dhe Mërgatës (2013-2018) të bëhet publik;
- **Me qëllim të përfshirjes së një numri më të madh të pjesëtarëve të diasporës në mësimet plotësuese të gjuhës amtare të:**
  1. Të përditësohen librat dhe materialet e tjera pedagogjike për arsim bazuar në nevojat e gjeneratave të ndryshme, dhe kështu programi të zhvillohet me metoda dhe mjete duke ju përshtatur niveleve të ndryshme të arsimit, në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
  2. Të hapen më shumë shkolla shqipe në Diasporë, sidomos në ato vende ku kemi më së shumti pjesëtarë të Diasporës, dhe kështu të promovohet hapja e shkollave të reja;
  3. Të krijohet një platformë për libra elektronik, e përditësuar dhe e mirëmbajtur;
  4. Të caktohen kriteret për mësimdhënësit e mësimit plotësues, financimin e proce, pagesat për mësuesit dhe kompetencat e tyre;
  5. Qeveria e Kosovës dhe Shqipërisë të dërgojë atashe/koordinator në vendet pritëse, të cilët do të kujdesen për mbarëvajtjen e mësimit plotësues në Diasporë;
  6. Të nënshkruhen marrëveshje bilaterale në mes të Kosovës dhe shteteve pritëse ku jetojnë pjesëtarët e Diasporës për organizimin e mësimit plotësues dhe kështu të lobohet që gjuha shqipe të futet në shtetet përkatëse sikurse gjuha frenge, angleze, etj;
  7. Të krijohet një listë e gjithë mësimdhënësve nëpër shtetet përkatëse nga konsullatat dhe kjo të jetë publike;
  8. Përzgjedhja e mësimdhënësve për mësim plotësues të bëhet nga dy ministritë (Kosovë dhe Shqipëri);
  9. Të ofrohen trajnime për ngritjen e kapaciteteve për mësimdhënësit edhe nëse nuk ka pagesë;
  10. Në organizimin e ngjarjeve të përbashkëta mes qeverive të vendeve amë si p.sh Samiti i Diasporës të trajtohet sa më shumë çështja e mësimit plotësues;
  11. Shërbimet diplomatike në vendet pritëse të promovojnë avancimin e mësimit plotësues në Diasporë;

- **Avancimi i rolit të medieve në fuqizimin e lidhjeve me Diasporën:**

1. Krijimi dhe përditësimi i databazës së mediave aktive në Diasporë, si gazetat, faqet e internetit, televizionet, portalet etj dhe kështu të krijohet një platformë publike me të dhënat e tyre;
2. Ndryshimi i ligjit për transmetuesin publik (RTK-në), të përcaktojë hapjen e një kanali të veçantë për Diasporën;
3. Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike të hartojë buletin informativ së paku një herë në muaj;
4. Të krijohet një program për Diasporën i përbashkët nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia;
5. Lidhja e marreveshjeve të reja me shtete e tjera për hapjen e një kanali të veçantë për diasporën;

- **Roli i studentëve nga Diaspora:**

1. Të thjeshtësohet procesi i nostrifikimit të diplomave;
2. Të caktohen kushtet të njejta për anëtarët e Diasporës në Seminarin e Albanologëve që organizohet nga Fakulteti Filologjik/Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". Poashtu, të zhvillohen më shumë vizita të albanologëve në Diasporë, të cilët mund të ofrojnë ligjerata dhe fjalime për komunitetin;
3. Të krijohen mundësitë për anëtarët e Diasporës që të studiojnë me korrespondencë në Universitetin e Prishtinës dhe në universitetet e tjera publike të Kosovës;
4. Qeveria e Kosovës dhe Shqipërisë të përkrahë projektet e shkencëtarve dhe hulumtuesve në fushën e arsimit plotësues në Diasporë;
5. Të bëhet më shumë promovim dhe njoftim për mundësitë e bursave për studentët nga Diaspora përmes video-kampanjave, rrjeteve sociale, buletineve informative, etj.

Për të ndjekur diskutimin e plotë, ju lutem klikoni [këtu](#).

Me respekt,

Liza Gashi, Drejtoreshë e Programeve



[diasporaflet.org](http://diasporaflet.org) | [organizatatshqiptare.org](http://organizatatshqiptare.org)

**Tel:** +377 (0) 44 771 426